



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 40, paragrafi 2, pika (b) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr-03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 27/2008), e konform nenit 29 lidhur me nenit 54 dhe 56, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 27.06.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2025–2027

Neni 1

Me këtë vendim miratohet korniza afatmesme-buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin **2025 – 2027** (në tekstin e mëtejme **KAB-i**).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe korniza afat mesme buxhetore 2025-2027 dhe lista e projekteve kapitale e viti 2025.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4


Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 010-34926
Më datë 27.06.2024



Kryesuesi i Kuvendit


Mr. ec Bexhet KUÇI